



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës

01 Nr. _____ /2019

Datë: 27.06.2019

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 dhe 73 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dhe nenit 4, 5 dhe 8.3 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016, për procedurën e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, në mbledhjen e mbajtur me datë 27.06.2019, pas diskutimit lidhur me pikën e 5 të rendit të ditës: Themelimi i Komitetit Konsultativ për Personat me Afësi të Kufizuara, e miratoi këtë:

V E N D I M

Për Formimi i Panelit përzgjedhës

1. Themelohet Paneli përzgjedhës për zhvillimin procedurave për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Personat me Afësi të Kufizuara në Komunën e Gjakovës me këtë përbërje:
 1. z. Nik Hisoni, anëtar i Kuvendit
 2. znj. Dalina Syl, anëtare e Kuvendit
 3. z. Ali Tafarshiku, anëtar i Kuvendit
 4. znj. Lumnie Shllaku, Zyrtare për Barazi Gjinore
 5. znj. Iliriana Luzha, përfaqësuese e shoqërisë Civile
2. Paneli përzgjedhës i caktuar në pikën e parë të këtij vendimi ka për detyrë që pas përfundimit të procedurave të parapara në Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016, për Procedurën e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, të propozoj Kuvendit të Komunës Listën me emrat e Komitetit Konsultativ për Personat me Afësi të Kufizuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.
4. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetari i Komunës z. Arçian Gjini,
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
 - Anëtarëve të panelit përzgjedhës.
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës
 - Arkivit



Kryetari i Kuvendit të Komunës

Anton shala